

Raiffeisen Invest -Shoqëri Administruese e Fondeve të
Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a

Raportimet Financiare për tremujorin I 2016 për
Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare

Prill 2016

Pasqyrat financiare të Raiffeisen Invest -Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	
Informacioni	Përshkrimi, vlera
Kodi i shoqërisë administruese	K5192800II
Numri i regjistrimit në QKR	
Numri për raportimin	1
Adresa	Blv. "Bajram Curri", ETC, Kati X-te
Telefon/fax	+355 042 277 901/5
Email:	edlira.konini@raiffeisen.al
Faqe Web	www.raiffeisen-invest.al
Data e licensimit	18 Tetor 2010
Emri dhe mbiemri i Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Administrativ	Serge Guay - Kryetar
	Christa Geyer-Nën Kryetare
	Barbora Valkova-anëtar
	Alda Shehu-anëtare
	Donalda Gjorga-anëtare
	Vanita Nikolla-anëtare
	Resmi Hibraj-anëtar
	Edlira Konini-anëtare
Pesë aksionerët më të mëdhenj (emri,mbiemri, adresa, ose emri i shoqërisë dhe adresa e zyrtare, përqindja e aksioneve në pronësi)	
Emri i shoqërisë	Raiffeisen Bank Albania
Adresa zyrtare	Rruga e Kavajes
Përqindja e aksioneve	100%
Numri i punonjësve	13
Shoqëria e ekspertit kontabël që ka audituar e fundit pasqyrat financiare	Deloitte Audit Albania sh.p.k
Banka (depozitari) me të cilin kryen veprimet shoqëria e administrimit	First Investment Bank, Albania
Numrat e llogarive:	
Nr e llogarive të Shoqërisë Administruese:	
Raiffeisen Bank	AL75 2021 1037 0000 0000 0095 9145
Raiffeisen Bank	AL34 2021 1013 0000 0001 0495 9145
First Investment Bank Albania	AL18 2151 1031 ALL1 0000 0401 7500
Nr e llogarive të Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen:	
First Investment Bank Albania	AL78 2151 1031 ALL1 0000 0393 3000
First Investment Bank Albania	AL93 2151 1031 ALL5 3000 0393 3000
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Prestigj:	
First Investment Bank Albania	AL43 2151 1031 ALL1 0000 0524 4100
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Invest Euro:	
First Investment Bank Albania	AL03 2151 1031 EUR1 0000 0610 6600

1. Pasqyra e Bilancit

Emri i shoqërisë administruese: Raiffeisen Invest-*Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.*

Kodi i shoqërisë: *K519280011*

Për datën: *31/03/2016*

AKTIVI	Shënime	Lek	Lek
		31/12/2015	31/03/2016
A. Aktive afatgjata (I+II+III+IV)		51.964.581	49.525.063
I. Aktive afatgjata materiale (1+2)		21.721.781	19.631.459
1. Toka dhe Ndërtesa			
2. Të tjera aktive afatgjata materiale	6	21.721.781	19.631.459
II. Aktive jo-materiale	7	10.090.800	9.586.354
III. Aktive financiare(1+2+3+4)		20.152.000	20.307.250
1. Depozita bankare			
2. Të vlefshme për shitje	8		
3. Të mbajtura deri në maturim	8	20.152.000	20.307.250
4. Të tjera aktive financiare afatgjata			
IV. Investimet që kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto			
B. Aktivi tatimor i shtyrë			
C. Aktive afatshkurtra (I+II+III+IV+V+VI)		307.394.035	356.373.226
I. Pajisje në magazinë, inventar i imët dhe pajisje të tjera			
II. Llogari të arkëtueshme tregtare (1+2+3+4)		74.613.987	76.271.191
1. Llogari të arkëtueshme nga fondet e pensioneve dhe investimeve	9	74.370.096	76.271.191
2. Llogari të arkëtueshme nga shumat e paguara tepër, bazuar në fitim.			
3. Llogari të arkëtueshme nga shteti dhe institucione të tjera	9	0	0
4. Të tjera llogari të arkëtueshme		243.890	
III. Aktive financiare (1+2)		0	0
1. Depozita bankare			
2. Të tjera aktive dhe llogari të arkëtueshme afatshkurtër të vlefshme për shitje	8		
3. Të tjera aktive dhe llogari të arkëtueshme afatshkurtër të mbajtura deri në maturim	8		
4. Kuota në fonde investimi			
IV. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (1+2)		232.563.799	279.936.359
1. Llogari rrjedhëse dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në bankë	10	232.563.799	279.936.359
2. Mjete monetare në arkë			
V. Shpenzime të parapaguara	11	216.250	165.676
VI. Shpenzime të llogaritura			
D. Totali i Aktiveve (A+B+C)		359.358.616	405.898.289

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare, të paraqitura në faqet 8 deri në 27.

PASIVI	Shënime	Lek	Lek
		31/12/2015	31/03/2016
A. Kapitali (I+II+III+IV+V+VI)		323.236.922	388.426.279
I. Kapitali i nënshkruar	12	90.000.000	90.000.000
II. Rezerva të kapitalit			
III. Rezerva e rivlersimit			
IV. Rezerva të tjera	13	9.000.000	9.000.000
V. Fitime / humbje të mbartura		4.089.636	224.236.922
VI. Fitimi /humbja neto për periudhën		220.147.286	65.189.356
B. Detyrime afatgjata (I+II+III)			
I. Detyrime ndaj fondeve të pensionit dhe investimeve			
II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi			
III. Detyrime të tjera afatgjata			
C. Detyrim tatimor i shtyrë			
D. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe			
E. Detyrime afatshkurtra (I+II+III+IV+V)		36.121.694	17.472.010
I. Detyrime ndaj fondeve të pensionit dhe investimeve			
II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi			
III. Llogari të pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme	14	36.121.694	17.472.010
IV. Shpenzime të shtyra			
V. Të ardhura të marra në avancë			
F. Totali i pasivit (A+B+C+D+E)		359.358.616	405.898.289

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare, të paraqitura në faqet 8 deri në 26.

2. Pasqyra e Fitim / Humbjeve

Emri i shoqërisë administruese: Raiffeisen Invest-*Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.*

Kodi i shoqërisë: *K5192800II*

Për datën: *31/03/2016*

	Shënime	Lek	Lek
		31/03/2015	31/03/2016
I. Të ardhura nga administrimi i fondit (1+2+3)		207.255.682	220.584.509
1. Tarifa të administrimit		207.255.682	220.584.509
a) Tarifa te administrimit nga Fondi i Investimit Raiffeisen Prestige		165.584.291	177.432.665
b) Tarifa te administrimit nga Fondi i Pensioneve Vullnetare Raiffeisen		891.869	1.250.076
c) Tarifa te administrimit nga Fondi i Investimit Raiffeisen Invest EURO		40.779.522	41.901.768
2. Tarifa të largimit nga fondit			
3. Tarifa të tjera			
II. Shpenzime nga administrimi i fondit (1+2+3+4)		71.239.700	83.351.300
1. Shpenzime të transaksioneve			
2. Shpenzime të marketingut			
3. Shpenzime të shitjes me agjent të fondeve të pensionit	15		
4. Shpenzime të shitjes me agjent të fondeve të investimeve	15	4.204.200	4.151.700
5. Shpenzime të tjera të administrimit të fondeve të pensionit	15		
6. Shpenzime të tjera të administrimit të fondeve të investimeve	15	67.035.500	79.199.600
III. Fitim / Humbja nga administrimi i fondit të pensionit/investimeve (+/-) (I - II)		136.015.982	137.233.209
IV. Të ardhura të tjera	16	173.490	1.052.068
V. Shpenzime të veprimtarisë së shoqërisë administruese (1+2+3+4+5+6)		38.912.096	47.592.442
1. Shpenzime për materiale			
2. Shpenzime për personelin	17	8.874.080	10.273.591
3. Amortizim i aktiveve materiale/jomateriale afatgjata		1.636.110	1.798.880
4. Rregullim i vlerës së aktiveve afashkurtra			
5. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe			
6. Shpenzime të tjera të veprimtarisë	18	28.401.905	35.519.971
VI. Të ardhura financiare	19	3.850.391	423.366
VII. Shpenzime financiare	19	122.128	207.897
VIII. Fitim / Humbja para tatimit (III+IV-V+VI-VII)		101.005.640	90.908.304
IX. Tatimi mbi fitimin	20	25.206.171	25.718.948
X. Fitim / Humbja neto për periudhën (VIII-IX)		75.799.469	65.189.356

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare, të paraqitura në faqet 8 deri në 26.

3. Pasqyra e Fluksit të Parave

Emri i shoqërisë administruese: Raiffeisen Invest -*Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipermarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.*

Kodi i shoqërisë: **K519280011**

Për datën: **31/03/2016**

	Lek	Lek
	31/03/2015	31/03/2016
a. Arkëtime nga veprimtaria shfrytëzuese	209.940.878	219.527.584
b. Pagesa për veprimtarinë shfrytëzuese	245.553.652	172.486.179
c. Flukse monetare neto nga veprimtaria shfrytëzuese (a - b)	-35.612.773	47.041.406
d. Arkëtime nga veprimtaria investuese		
e. Pagesa për veprimtarinë investuese	-2.400.436	-180.853
f. Flukse monetare neto nga veprimtaria investuese (d - e)	-66.136.330	512.007
g. Arkëtime nga veprimtaria financuese	463.863.670	195.512.007
h. Pagesa për veprimtarinë financuese	-530.000.000	-195.000.000
i. Fluksi monetar neto nga veprimtaria financuese (g - h)		
j. Rritja/rënia neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (c+f+i)	-101.749.104	47.372.560
k. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fillim të periudhës kontabël	112.288.985	232.563.799
l. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund të periudhës kontabël (j+k)	10.539.881	279.936.359

Pasqyra e rrjedhjes së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare, të paraqitura në faqet 8 deri në 26.

4. Pasqyra e ndryshimit të kapitalit

Emri i shoqërisë administruese: Raiffeisen Invest -Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

Kodi i shoqërisë: **K519280011**

Për periudhën: **01/01/2016 - 31/03/2016**

	Lek	Lek	Lek	Lek
	31/12/2015	Rritje	Zbritje	31/03/2016
I. Kapitali i nënshkruar	90.000.000	0	0	90.000.000
II. Rezerva kapitali	9.000.000		0	9.000.000
III. Rezerva e rivlerësimit				
IV. Rezerva të tjera				
V. Fitime (Humbje) të mbartura	4.089.636			4.089.636
VI. Fitimi (Humbja) e periudhës financiare	220.147.286	65.189.356		285.336.643
VII. Pagesat e dividendit	0	0		0
VIII. Ndryshimet në politikat kontabël dhe korigjime (1+2+3+4+5+6)	0	0	0	0
1. Kapitali i nënshkruar				
2. Rezerva kapitali				
3. Rezerva e rivlerësimit				
4. Rezerva të tjera				
5. Fitime (Humbje) të mbartura				
6. Fitimi (humbja) e periudhës financiare				
IX: Shuma që i takon interesit të pakicës				
TOTALI I KAPITALIT	323.236.922	65.189.356	0	388.426.279

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit duhet të lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare, të paraqitura në faqet 8 deri në 26.

5 Pasqyra e strukturës së investimeve
5.2 Obligacionet

Emri i shoqërisë administruese: Raiffeisen Invest -*Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Siper marrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.*

Emri i shoqërisë administruese: *Raiffeisen Invest*

Për periudhën: *31/03/2016*

Lloji	Vlera nominale (Lek)	Shpenzimet e blerjes (Lek)	Vlera në datën e raportimit (Lek) 01/01/2016	Vlera në datën e raportimit (Lek) 31/03/2016
Obligacione të Qeverisë (brenda vendit)	20.000.000	20.000.000	20.152.000	20.307.250
HTM	20.000.000	20.000.000	20.152.000	20.307.250
Primar	20.000.000	20.000.000	20.152.000	20.307.250
AL0006NF7Y20	5.000.000	5.000.000	5.102.500	5.010.250
AL0017NF5Y18	15.000.000	15.000.000	15.049.500	15.297.000
HFT	0	0	0	0
Primar	0	0	0	0
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË EMETUESVE VENDAS	20.000.000	20.000.000	20.152.000	20.307.250
Obligacione të Qeverive (jashtë vendit)				
Obligacione të shoqërive (jashtë vendit)				
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË EMETUESVE TË HUAJ				

1. HYRJE

Raiffeisen Invest -Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. (“në vijim Shoqëria”) është një shoqëri aksionare shqiptare me seli në Tiranë. Shoqëria është regjistruar në Regjistrin Tregtar me Vendim të Gjykatës së Rrethit, Tiranë Nr. 33825, datë 18 korrik 2005. Zyra qendrore e Shoqërisë është në Bul.Bajram Curri, ETC, Kati 10-të Tiranë.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10197, datë 12/12/2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” i cili midis të tjerash parashikonte ndarjen e veprimtarisë së Shoqërisë Administruese nga Fondi i Pensionit Vullnetar, më datë 18 tetor 2010, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Liçencën Nr.1, liçenoi “Shoqërinë Administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a”, për të vepruar si shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit.

Gjithashtu, bazuar në Ligjin nr. 10198 datë 10.12.2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr. 179, datë 13/12/2011, licenoi Shoqërinë, për të kryer veprimtarinë e administrimit të asetëve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive, krahas veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit vullnetar (Licenca nr.1, datë 13.12.2011).

Rrjedhimisht, emri ligjor i Shoqërisë ndryshoi në: Raiffeisen Invest-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

Raiffeisen Invest sh.a aktualisht administron tre fonde si më poshtë:

1. Fondin e pensionit Vullnetar Raiffeisen
2. Fondin e investimit Raiffeisen Prestigj
3. Fondin e investimit Raiffeisen Invest-Euro

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

b) Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare për tregtim, të cilat janë matur me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lek”, e cila është monedha funksionale dhe prezantuese.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në këto pasqyra financiare.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të pasqyrës së pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të vitit. Aktivitetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhën funksionale me kursin e datës së caktimit të vlerës së drejtë. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

(b) Të ardhurat nga investimet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat e investimeve njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset në momentin fillestar të njohjes së aktivitetit, ose detyrimit financiar dhe nuk ndryshohet në periudhat e mëtejshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjeve, primeve të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë të lidhura me blerjen, emetimin ose ç'rregjistrimin e aktivitetit, ose detyrimit financiar.

(c) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative regjistrohen kur ato ndodhin.

(d) Përfitimet e punonjësve

- *Sigurime shoqërore*

Shoqëria paguan kontribute të sigurimeve shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione.

- *Plan pensioni vullnetar*

Shoqëria ka krijuar një plan pensioni vullnetar për punonjësit e saj brenda Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen.

- *Leja vjetore e paguar*

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostos së vlerësuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

- *Përfitimet afat-shkurtra*

Detyrimet për përfitime afatshkurtra nuk skontojnë dhe regjistrohen në periudhën kur ofrohet shërbimi.

(e) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit.

Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi, ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë llogaritet duke përdorur metodën e bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e mbylljes së diferencave, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ky aktiv mund të përdoret. Aktiv i tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Tatime shtesë mbi fitimin që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë kur njihet dhe detyrimi për të paguar dividend.

(f) Aktivët dhe detyrimet financiare

i Njohja

Aktivët financiarë njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në ditën kur entiteti bëhet pale kontraktuale në lidhje me një instrument në përputhje me blerjen e rregullt të tij. Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje e një instrumenti financiar njihet si date kontabilizimi të aktivitetit, datën e shlyerjes. Dita e shlyerjes është dita kur aktiviteti i levrohet entitetit. Dita e shlyerjes i referohet a) njohjes së aktivitetit në ditën kur ai merret nga entiteti b) c' regjistrimit të aktivitetit dhe njohjes së fitimit/humbjes neto nga shitja në ditën kur ai livrohet/dergohet nga entiteti. Kur aplikohet dita e shlyerjes, entiteti kontabilizon çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivitetit gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes. Me fjalë të tjera, ndryshimi në vlerë nuk njihet për aktivitetet të mbajtura me kosto ose kosto të amortizuara; por njihet si fitim ose humbje për aktivitetet e klasifikuara si aktive financiare të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për aktivitetet e vlefshme për shitje.

Detyrimet njihen fillimisht në datën kur entiteti bëhet palë e kontratës.

ii Ç' regjistrimi

Fondi c' regjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të parase nga aktiviteti financiar, ose kur të drejtat për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale të aktivitetit financiar janë transferuar në një transaksion me të cilin transferohen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Fondi nuk njihet një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

Fondi merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të gjitha ose kryesisht në të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivitetet e transferuara nuk ç' regjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Në transaksionet në të cilat Fondi as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivitetet financiare, aktiviteti ç' regjistrohet nëse kontrolli mbi to humbet.

iii Matja e vlerës së drejtë

Pas njohjes fillestare të gjitha aktivitetet financiare (përveç atyre të mbajtura deri në maturitet) maten me vlerën e drejtë. Përkufizimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është përcaktuar duke përdorur teknika të vlerësimit. Metodatat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerësimit

aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara dhe krahasimin me instrumente të tjerë të ngjashëm, për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Ndryshimet në vlerën e drejtë janë njohur menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

iv Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Fondi vlerëson, nëse ka një evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim - humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe që ngjarja që sjell humbje ka ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

v. Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të fiksuar që Shoqëria ka synimin e qartë dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose në dispozicion për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim që nuk janë afër maturimit të tyre do të rezultonte në riklasifikimin e të gjithë investimeve të mbajtura deri në maturim si të disponueshme për shitje, dhe do të parandalonte Kompaninë të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si instrumenta të mbajtura deri në maturim për periudhën aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

vi. Investimeve të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Fondi mban disa instrumenta me vlerën e drejtë, me ndryshimet e vlerës së drejtë të njohura menjëherë në fitim ose humbje, siç përshkruhet në politikën kontabël 2 (c) (iii). Një prezantim të detajuar të matjeve të vlerës së drejtë mund ta gjeni në shënimin 6 dhe 7.

(g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare me shkallë likuiditeti të lartë me maturitet më të vogël se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Shoqëria për administrimin e angazhimeve afat-shkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

(h) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë dhe maten në vazhdim me kosto të amortizuar, duke i zbritur zhvlerësimin (sipas shënimit 3 (m)).

(i) Aktive afatgjata materiale

• Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Kur pjesët e një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçantë të aktiveve afatgjata materiale.

• Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen

atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

- *Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me metodën e vlerës së mbetur. Aktivitet me qira zhvlerësohen për më të voglën mes periudhës së qirasë dhe jetëgjatësisë së dobishme.

Përqindjet vjetore të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Kategoria e aktivitet	2015	2016
• Pajisje zyre	20%	20%
• Pajisje informatike	25%	25%
• Mjete transporti	20%	20%

(j) Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale të blera nga Shoqëria njihen me kosto historike, zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të këtij aktivitet. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave bazuar në metodën e vlerës së mbetur. Norma e amortizimit vjetor është 25%.

(k) Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë mbajtur me kosto të amortizuara.

(l) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet.

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivitet ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Vlera e rikuperueshme e një aktivitet, ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, fluksat e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitet.

Humbjet e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse ka evidencë se rënia në vlerë është zbutur, ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitet nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke zbritur zhvlerësimin apo amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur më parë ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

(m) Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të mirat ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjionet caktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para taksës e cila reflekton vlerën e tregut dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

4. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

(a) Të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiare e ekspozon Shoqërinë ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional
- rreziku rregullator
- rreziku i mos-diversifikimit
- rreziku i palës tjetër
- rreziku i performancës
- rreziku i personelit kyç
- rreziku i vlerësimit të aseteve
- Rreziku i kursit të këmbimit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut dhe administrimin e kapitalit të Shoqërisë.

Struktura e administrimit të rrezikut

Sipas ligjit nr.10197, datë 12 dhjetor 2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”si dhe Ligjit nr. 10198, datë 12 dhjetor 2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” Shoqëria administruese duhet të ketë një funksion për administrimin e rrezikut. Në strukturën administrative, Drejtori i menaxhimit të Risk-ut është përgjegjës për administrimin e rreziqeve.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga institucioni financiar, për të vendosur kufizime dhe kontrole dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Shoqëria, përmes standardeve dhe procedurave administrative, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrat e tij.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare nëse emetuesi i instrumentit financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Shoqëria administruese, si investitor ne letra me vlere te qeverise shqiptare është e ekspozuar ndaj këtij rreziku në rast se qeveria shqiptare has vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të saj ndaj mbajtësve të letrave me vlerë qe ajo ka emetuar.

Investimet në letra me vlerë sipas kategorisë së vendit janë detajuar si më poshtë:

	Letra me vlerë të tregtueshme	
	31 mars 2015	31 mars 2016
Pa vonesa dhe të pazhvlerësuara Afatshkurtra: norma B+ (Shqipëria) Standard & Poor's	171,588,728	20,307,250
Vlera kontabël	171,588,728	20,307,250

Rrezikut i normave të interesit

Është rreziku që i vjen vlerës së portofolit të shoqërisë si pasojë e paparashikueshmërisë së levizjes së normave të interesit në treg. Më konkretisht, ky rrezik vjen si pasojë e lëvizjes në kah të kundërt të çmimit të instrumenteve dhe normave të tyre të interesit. Kur normat e interesit rriten, çmimi i instrumenteve financiare bie, dhe anasjelltas.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që asetet e shoqërisë të mos shiten në kohë dhe me vlerën e tregut si pasojë e mungesës së likuiditetit në treg. Në këtë rast Shoqëria mund të hasë vështirësi për të shlyer detyrimet financiare në kohën e duhur.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive, do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë apo vlerën e instrumentave financiarë. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të manaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë, apo të tërthortë që vjen si rezultat i gabimeve njerëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregtimit, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Kompanisë.

Objektivi i Shoqërisë është të manaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit të cilat kufizojnë ekspozimit ndaj këtij rreziku.

Rreziku rregullator

Rreziku rregullator lidhet me mundësinë e ndryshimeve të kuadrit rregullator, përfshirë legjisllacionin tatimor.

Rreziku i mos-diversifikimit

Duke qenë se Kompania do të investojë kryesisht në Letra me Vlerë të Qeverisë, portofoli i saj do të ketë një nivel të kufizuar diversifikimi dhe për rrjedhojë, mund të jetë më i ndjeshëm ndaj ndryshimeve ekonomike, politike, të biznesit ose të tjera që prekin emetues ose investime të ngjashme, krahasuar me një fond të diversifikuar.

Rreziku i palës tjetër

Ky është rreziku që pagesa në një sistem transfertash të mos kryhet ose të kryhet me vonesë. Ai lidhet me moszbatimin e kushteve të një marrëveshjeje të paracaktuar, p.sh. mospagesën tek shitësi ose mosdorëzimin e objektit të marrëveshjes tek blerësi.

Rreziku i personelit kyc

Performanca e Kompanisë, pjesërisht i atribuohet aftësive profesionale të personave përgjegjës në shoqërinë administruese dhe vendimarrjes së duhur nga ana e administratorëve. Por, duke qenë se stafi i shoqërisë administruese mund të ndryshojë, vendimarrja e re mund të rezultojë më pak e suksesshme.

Rreziku i vlerësimit të asetëve

Ky lloj rreziku është tipik për tregjet jo likude ose për tregjet që përballen me kriza financiare dhe humbje të besimit. Shoqëria administruese mund të jetë e detyruar të shesë letra me vlerë nga portofoli i saj, me një çmim të ndryshëm nga çmimi i vlerësimit të tyre.

5. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Në rastin e letrave me vlerë të tregtueshme vlera e drejtë është vlera e tregut. Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare për të cilat nuk ka çmime tregu kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit të përshkruara në politikat kontabël 3(h).iii. Për instrumentet financiare që tregtohen jo në mënyrë të shpeshtë dhe kanë pak transparencë në çmim, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon shkallë të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqëndrimit, pasigurisë të faktorëve të tregut, supozimeve të çmimit, dhe rreziqe të tjera që prekin instrumentin specifik.

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat rezidente. Sikurse këto gjendje janë afatshkurtër, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën e mbartur.

Investimet në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e flukseve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur. Investimet në letrat me vlerë janë mbajtur me vlerën e drejtë.

6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Automjete	Pajisje zyre dhe Informatike	Totali
<i>Kosto</i>			
Gjendja më 1 janar 2015	7.484.139	11.790.440	19.274.579
Shtesa		18.056	18.056
Pakësime			
<i>Zhvlërësimi i akumuluar</i>			
Gjendja më 1 janar 2015	2.752.179	3.176.465	5.928.644
Shpenzimi 3-mujorit te I viti 2015	236.598	533.781	770.379
Pakësime			-
Gjendja më 31 mars 2015	2.988.777	3.710.246	6.699.023
<i>Gjendja e mbartur</i>			
Me 1 janar 2015	7.484.139	11.790.440	19.274.579
Gjendja më 31 mars 2015	4.495.362	8.098.250	12.593.612
<i>Kosto</i>			
Gjendja më 1 janar 2016	18.483.849	12.267.088	30.750.937
Shtesa		29.016	29.016
Pakësime	1.541.980		1.541.980
<i>Zhvlërësimi i akumuluar</i>			
Gjendja më 1 janar 2016	3.698.571	5.330.586	9.029.157
Shpenzimi 3-mujorit te I viti 2016	719.578	423.019	1.142.597
Pakësime	565.239		565.239
Gjendja më 31 mars 2016	3.852.909	5.753.605	9.606.514
<i>Gjendja e mbartur</i>			
<i>Më 1 janar 2016</i>	18.483.849	12.267.088	30.750.937
Gjendja më 31 mars 2016	13.088.960	6.542.499	19.631.459

Nuk ka aktive të vendosura si kolateral më 31 mars 2016.

7.AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

	Programe Kompjuterike
<i>Kosto</i>	
Gjendja më 1 janar 2015	19.644.342
Shtesa	2.382.380
Pakësime	
Gjendja më 31 mars 2015	22.026.722
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>	
Gjendja më 1 janar 2015	8.472.999
Shpenzimi për 3-mujorin e I viti 2015	865.731
Pakësime	
Gjendja më 31 mars 2015	9.338.730
<i>Gjendja e mbartur</i>	
Më 1 janar 2015	11.171.344
Gjendja më 31 mars 2015	12.687.993
<i>Kosto</i>	
Gjendja më 1 janar 2016	22.026.722
Shtesa	151.837
Pakësime	235.152
Gjendja më 31 mars 2016	21.943.407
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>	
Gjendja më 1 janar 2016	11.935.922
Shpenzimi për 3-mujorin e I viti 2016	656.283
Pakësime	235.152
Gjendja më 31 mars 2016	12.357.053
<i>Gjendja e mbartur</i>	
Më 1 janar 2016	10.090.800
Gjendja më 31 mars 2016	9.586.354

8. INVESTIME TE MBAJTURA PER TREGTIM

Investimet në letra me vlerë mund të detajohen si më poshtë:

Të tregtueshme	31 mars 2015	31 mars 2016
Afatgjata		
Obligacione qeveritare	134.757.126	-
	134.757.126	-
Afatshkurtra		
Bono thesari	34.669.453	-
	34.669.453	-

	Vlera nominale	(Skonto)/Prim I paamortizuar	Interesa të përlogaritura	Vlera e tregut
Bono thesari	35.000.000	-330.547		34.669.453
Obligacione qeveritare afatgjata	133.000.000	615.259	1.141.867	134.757.126
Më 31 mars 2015	168.000.000	284.712	1.141.867	169.426.579
	Vlera nominale	(Skonto)/Prim I paamortizuar	Interesa të përlogaritura	Vlera e tregut
Bono thesari				
Obligacione qeveritare afatgjata				-
Më 31 mars 2016

8. INVESTIME TE MBAJTURA PER MATURIM

Të mbajtura në maturim	31 mars 2015	31 mars 2016
Afatgjata		
Obligacione qeveritare	20.307.250	20.307.250
	20.307.250	20.307.250
Afatshkurtra		
Bono thesari	-	-

	Vlera nominale	(Skonto)/Prim I paamortizuar	Interesa të përlllogaritura	Vlera kontabël
Bono thesari				
Obligacione qeveritare	20.000.000		307.250	20.307.250
Më 31 mars 2015	20.000.000		307.250	20.307.250
	Vlera nominale	(Skonto)/Prim I paamortizuar	Interesa të përlllogaritura	Vlera kontabël
Bono thesari	-	-	-	-
Obligacione qeveritare	20.000.000		307.250	20.307.250
Më 31 mars 2016	20.000.000	-	307.250	20.307.250

9. LLOGARI TË ARKËTUESHME

	31 mars 2015	31 mars 2016
Te arketueshme nga fondi i Pensionit	316.420	436.570
Te arketueshme nga fondi i Investimit Prestigj	57.828.091	60.673.353
Te arketueshme nga fondi i Investimit EURO	13.900.198	15.161.269
Te tjera		
	72.044.709	76.271.191

10. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

Paraja dhe ekuivalentet e saj janë mbajtur me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe përbëhen nga:

	31 mars 2015	31 mars 2016
Llogari në banka në lek	10.539.881	11.396.524
Depozita		268.000.000
Garanci bankare		539.835
Totali	10.539.881	279.936.359

Llogaritë në banka dhe në Lek janë detajuar si më poshtë:

	31 mars 2015	31 mars 2016
Llogari rrjedhëse pranë:		
Raiffeisen Bank	7.566.174	276.516.582
First Investment Bank	2.973.707	3.419.777
Totali	10.539.881	279.936.359

11. SHPENZIME TE PARAPAGUARA

	31 mars 2015	31mars 2016
Shpenzime të parapaguara Personeli Paga 13		
Shpenzime të parapaguara Personeli Sig. Shend Privat	71.432	165.676
Te tjera		
Totali	71.432	165.676

12. KAPITALI AKSIONAR

Në bazë të Kontratës së shitjes, firmosur më 26 dhjetor 2008, Raiffeisen Bank Sh.a ka blerë 100% të aksioneve dhe është bërë aksioneri i vetëm i Shoqërisë. Raiffeisen Bank është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si aksioner i vetëm i Shoqërisë më 15 janar 2009. Raiffeisen Bank Sh.a. është regjistruar në Tiranë.

Më 31 mars 2016 kapitali aksionar është 90,000,000 Lek, i ndarë në 12,857 aksione me vlerë nominale prej 7,000 Lek secili. Struktura aksionare më 31 mars 2016 paraqitet si më poshtë:

	31 mars 2015		31 mars 2016	
	Në %	Në Lek	Në %	Në Lek
Raiffeisen Bank sh.a	100	90.000.000	100	90.000.000
Totali	100	90.000.000	100	90.000.000

13. REZERVA LIGJORE

Shoqëria Administruese mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe në statutin e saj ka krijuar rezervën ligjore në të cilën transferon minimalisht 5 % të fitimit pas tatimit të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës deri në 10% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, apo me një vlerë më të lartë, të përcaktuar në statut.

Gjendja në rezervën ligjore më datë 31.03.2016 është 9,000,000 lekë ose 10% e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.

14. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera dhe parashikimet për detyrime dhe pagesa përbëhen si më poshtë:

	31 mars 2015	31 mars 2016
Shpenzime të përllogaritura auditimi	882.002	1.217.836
Detyrime për sigurimet shoqërore	364.573	377.564
Tatim mbi të ardhurat personale	295.170	339.732
Tatim Fitimi	14.774.900	1.619.257
Furnitorë	2.261.614	3.700
Të tjera	87.228	106.706
Detyrime për personelin	7.548.751	5.803.328
Detyrime për IN2	512.303	178.713
Detyrime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare nga Fondi i Pensionit	2.780.179	43.570
Detyrime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare nga Fondi i Investimit-Prestigj		2.388.557
Detyrime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare nga Fondi i Investimit-EURO		506.909
Detyrime për Bankën Kujdestare për Fondin e Pensionit	4.834.576	58.249
Detyrime për Bankën Kujdestare për Fondin e Investimit -Prestigj		3.466.576
Detyrime për Bankën Kujdestare për Fondin e Investimit -EURO		1.499.349
Tatim ne burim	56968,22	55.676
Divident per tu paguar		
Detyrime ndaj RBAL	26.592.300	19.700
Totali	60.990.565	17.472.010

15. SHPENZIME NGA ADMINISTRIMI I FONDEVE

Shpenzimet nga administrimi i fondeve përbëhen si më poshtë:

	31 mars 2015	31 mars 2016
Shpenzime të shitjes me agjent	4.204.200	4.151.700
Shpenzime të tjera të administrimit të fondeve të pensionit dhe investimeve	67.035.500	79.199.600
Totali	71.239.700	83.351.300

16. TË ARDHURA TE TJERA

Të ardhurat e tjera përbëhen si më poshtë:

	31 mars 2015	31 mars 2016
Të ardhura nga ndryshimi i kursit të këmbimit		
Të ardhura nga rivlerësimi i letrave me vlerë	173.490	
Të ardhura nga shitja e AQ		1.052.068
Totali	173.490	1.052.068

17. SHPENZIMET PËR PERSONELIN

Shpenzimet për personelin përbëhen si më poshtë:

	31 mars 2015	31 mars 2016
Paga, shpërblime	8.003.013	9.078.382
Sigurime shoqërore	643.370	665.188
Kosto të tjera të personelit	227.697	530.022
Totali	8.874.080	10.273.591

Më datën 31 mars 2016, Shoqëria ka të punësuar 13 punonjës.

18. SHPENZIME TË TJERA TE PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Shpenzimet e përgjithshme administrative përbëhen si më poshtë:

	31 mars 2015	31 mars 2016
Tarifë auditimi	210.210	355.415
Udhëtime dhe dieta	116.230	308.341
Shpenzime telefonike dhe internet	35.547	31.871
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare(pensionet)	31.716	43.570
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare(prestigi)	6.785.786	7.130.942
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare(EURO Fund)	1.380.498	1.435.234
Publicitet, reklama		
Sponsorizime	-	4.079.000
Shpenzime karburanti dhe parkimi	157.571	260.194
Taksa dhe gjoba	137.029	
Shpenzime për bankën deponitare (Pensione)	118.998	166.757
Shpenzime për bankën deponitare (Prestigi)	9.645.923	10.149.749
Shpenzime për bankën deponitare (Euro Fund)	4.197.090	4.275.196
Siguracion		61.620
Të tjera	3.024.894	1.536.945
Shpenzime mirëmbajtje Invest 2/Bloomberg/Reuters	707.882	1.808.110
Shpenzime kontrata dhe prospekte	391.320	514.020
Komisione	1.456.212	1.255.140
Noter dhe shpenzime ligjore	5.000	171.248
Shpenzime te tjera per personelin		54.825
Shpenzime TVSH		756.854
Qira		1.124.940
Totali	28.401.905	35.519.971

19. TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Të ardhurat nga interesat sipas kategorive përbëhen nga:

<i>Te ardhura financiare</i>	31 mars 2015	31 mars 2016
Obligacione qeveritare	2.117.839	339.750
Bono thesari	340.163	
Depozita dhe llogari rrjedhëse	160.055	83.616
Kuota ne fond investimi	1.232.334	
Obligacione qeveritare (amortizim i premium)		
Të ardhura nga ndryshimi i kursit të këmbimit		
Të ardhura nga interesa të fituara gjatë periudhës	3.850.391	423.366

Shpenzimet financiare përbehen nga:

<i>Shpenzime financiare</i>	31 mars 2015	31 mars 2016
Obligacione qeveritare (amortizim i premium)	- 4.447	
Shpenzime nga ndryshimi i kursit të këmbimit	126.575	207.897
Shpenzime nga rivleresimi I letrave me vlere		
Shpenzime nga interesa të fituara gjatë periudhës	122.128	207.897

20. TATIM FITIMI

Shoqëria ka përcaktuar tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Në vitin 2016, për shoqëritë shqiptare norma e tatimit është e barabartë me 15% (2015:15%) të të ardhurave të tatueshme.

Më poshtë paraqitet rakordimi i tatimit mbi fitimin i përllogaritur me normën e aplikueshme të tatimit me fitimin kontabël:

	31 mars 2015	31 mars 2016
Fitimi përpara tatimit	101.005.640	90.908.304
Tatim fitimi i përllogaritur me 15%	25.206.171	13.636.246
Efekti tatimori shpenzimeve të pazbritshme		12.082.702
Shpenzime tatimi fitimi	25.206.171	25.718.948

21. PARASHIKIME DHE ANGAZHIME

Më 31 mars 2016, Shoqëria nuk është e përfshirë në kërkesa dhe procedura ligjore.

22. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palë e lidhur konsiderohet një entitet nëse (direkt ose indirekt përmes një ose më shumë ndërmjetësve, pala (i) kontrollon, kontrollohet është nën kontroll të përbashkët, entiteti (ii) ka një interes në entitetin që ka një ndikim të ndjeshëm mbi entitetin; (iii) ka një kontroll të përbashkët mbi entitetin (b) pala është një partnere e entitetit; (c) pala është në një pjesëmarrje e përbashkët në të cilën entiteti është një sipërmarrës; (d) pala është një anëtare kyçe e administrimit të shoqërisë ose shoqërisë mëmë; (e) pala është një anëtare e afërt e familjes të individit të sipërpërmendur në (a) ose (d); (f) pala është entitet që kontrollohet, kontrollohet bashkarisht ose influencohet, ose për të cilën ruan fuqinë më të madhe të votimit, direkt apo indirekt për çdo individ të referuar në (d) ose (e) ose (g) pala është një plan përfitimi pas-punësimit në dobi të punonjësvë të njësisë.

Një transaksion me një palë e lidhur është transferim burimesh, shërbimesh ose detyrimesh nëpërmjet palëve të lidhura, pavarësisht nga çmimi i faturuar.

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura me shoqërinë mëmë Raiffeisen Bank sh.a. më 31/03/2016 njësia ka hyrë në transaksionet e mëposhtme dhe balanca me palët e lidhura:

	31 mars 2015	31 mars 2016
Pasqyra e pozicionit financiar		
Paraja dhe ekuivalentet e saj	7.566.174	276.516.582
Totali	7.566.174	276.516.582
Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave		
Të ardhura		
Të ardhura nga transaksionet		
Të ardhura/shpenzime neto nga komisionet	- 35.886	- 23.951
	- 35.886	- 23.951
Shpenzime		
Pagesa për drejtimin	2.081.178	2.466.877
	2.081.178	2.466.877

NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim, ose prezantim në pasqyrat financiare.

Zv.Administratore e Përgjithshme

Edlira Konini

Kryespecialiste e Financës dhe Kontabilitetit

Ivana Karapici